



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201700378/2**

**Tiranë** \_\_\_\_/\_\_\_\_/2017

**Lënda :**            *Rekomandohet marrja e masave për shpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes administrative me Nr.31023-05513-86-2015akti, datë 04.09.2015 të shtetasit S. T. nga Tirana.*

**Drejtuar :**        **Z. KASTRIOT SELITA**  
**Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit**

**TIRANË**

**Për dijeni :**      **Z.Sinan TAJAJ**  
Rr."Nikolla Lena", Nr.62

**TIRANË**

***I nderuar zoti Kryetar,***

Në ankesën e tij drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi S. T., Kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë Tiranë, na shkruan se aktualisht ndodhet në një konflikt gjyqësor me ish Komunën Dajt Tiranë dhe për zgjidhjen e këtij konflikti ai është drejtuar rrugës gjyqësore. Nga ankesa e tij rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka shqyrtuar kërkesë padinë e tij ka vendosur pranimin e padisë, por pala e Paditur ish Komuna Dajt, ka ankuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke kërkuar prishjen e tij si i pabazuar në ligj.

Dosja e tij nga data 09.07.2015 e deri më sot ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe ajo nuk ka planifikuar akoma gjykimin e saj. Ankuesi na shkruan se në disa raste i është drejtuar me kërkesë Drejtuesit të kësaj Gjykate duke kërkuar shpejtim gjykimi dhe akoma nga ana juaj nuk po caktohet gjykimin dhe për këto arsye ai ka edhe kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, që të shikohen mundësit ligjore nga ana juaj të këtij shpejtim gjykimi.

Duke analizuar në tërësi rrethanat e kësaj çështje gjyqësore konstatohet se pretendimet e ankuesit S. T. gjenden të drejta dhe të bazuar në ligj dhe vlerësohet që nga ana jonë për rastin konkret të ndërhyhet me rekomandim Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për të parë mundësitë ligjore të shpejtimin të procedurave gjyqësore të rastit të shtetasit S. T.

Kështu në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, garantohej e drejta e një gjykimit të drejtë dhe publikë brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në nenin 28 të Kodit Procedurës Civile, parashikohet fakti se Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt ligjor duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Në nenin 49/2 të Ligjit me Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", thuhet se: "Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga dita e ardhjes së ankimit në Gjykatë ku është paraqitur ankimi.

Një veprim i tillë konsidrohet shkelje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe nga Gjykata Kushtetuese e RSH, me vendimin e saj Nr.85/2015 në të cilin midis të tjerave arsyetohet se:

"Ligji synon në thjeshtimin e procedurave ligjore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe garantimin e mbrojtjes efektive të drejtës së subjektit dhe të interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor brenda afateve sa më të shpejta e të arsyeshme".

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave të Njeriut, nga administrata publike", dhe bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku parashikohet se: "Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandim për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive", ju

### **REKOMANDOJMË:**

1. Shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative datë 04.09.2015, të shtetasit S. T. nga Tirana.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afati 30 ditor.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**